



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

DETYRË PROJEKTIMI

PËR REALIZIMIN E STUDIM PROJEKTIMIT:

**“NDËRTIMI I TREGUT PËR SHITJET ME SHUMICË DHE PAKICË TË
PRODUKTEVE USHQIMORE (TIRANA AGRIKULTURË) – Faza III-të**

Tiranë

Bashkia e Tiranës, me fondit 7,936,971.43 lekë (me TVSH) kërkon të realizojë studim projektimin për objektin: Ndërtimi i tregut për shitje me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore (Tirana Agrikulturë) – Faza III- të, në Njësinë Administrative Farkë me vlerë ndërtim montimi 300.000.000 lekë me tvsh.

1. Të dhëna dhe kërkesa të përgjithshme

Në territorin e Njësisë Administrative Farkë, Midis Kryqezimit të rrugës së Fushave dhe rrugës "Kroi i Pishës në Kufi me Unazën e Madhe të Tiranës, (segmenti nga Teg tek zona e Brrylit) është realizuar Tregu Agroushqimor nga Tirana Agrikulturë. Sipërfaqja Totale aktuale e të gjithë tregut ku përfshihen Godinat, Ambientet e Sherbimit etj është rreth 20.000 m².

Aksesi:

Hyrja kryesore është nga Jug-Lindja.

Tregu është i aksesuar drejtpërdrejt nga rrugët kryesore të Njësisë Administrative dhe Nga Unaza e Madhe e Tiranës.

Ky treg, aktualisht shfrytëzon një hapësirë prej rreth 20.000 m² tokë në Zonën Kadastrale 1604, Indeksi i Hartes K-34-100-(29C). Numri i pasurisë 404.

Situata aktuale:

- Aktualisht është ndërtuar tregu në këtë zonë me 4 godina përkatësisht nga rreth 1500 m². Dhe është duke u ndërtuar tregu i hapur midis ketyre godinave. Janë realizuar gjithashtu rrjeti rrugor dhe godinat e shërbimit dhe pritet të realizohen hapësira e parkimit në pjesën lindore të godinave si dhe e gjithë infrastrukture ndihmese (mure rrethuese, sinjalistika, sistemi i monitorimit dhe kontrollit të qarkullimit dhe sigurisë, rrjeti i ndricimit rrugor se bashku me kabinat).

Sipërfaqja e truallit ku parashikohet zhvillimi i mëtejshëm i Fazës së III është rreth 25000 m². Si pozicionim gjeografik zona kadastrale ku bën pjesë pasuria e propozuar për ndërtimin e strukturës së agregatorit bujqësor shtrihet midis liqenit të Farkës dhe segmentit Jug-Lindor të unazës së madhe të Tiranës. Ky pozicionim i pasurisë krijon mundësinë e lidhjes së strukturës së Agregatorit me rrjetin rrugor qytetas dhe ndërqytetas nëpërmjet unazës së madhe.

Ndërtimi i këtij tregu ka qenë i parashikuar të realizohet në tre faza ku Faza e Parë ka përfunduar, Faza e Dytë është duke u realizuar dhe faza e III. Në qendër të volumeve është parashikuar një treg i hapur në të cilën shitësit mund të reklamojnë produktet e tyre dhe blerësit potencial mund të vendosin për produktet.

Objekt i këtij projekti do të jetë ndërtimi i fazës së tretë të tregut me të gjithë elementet vazhdimi e strukturave aktuale, rrjetit rrugor dhe të shërbimeve të realizuar deri me tani, në parashikim me të gjithë kërkesat e zonës.



Gjurma Tregut

2. Kërkesa të veçanta

2.1 Projektuesi duhet të kryejë të gjithë punën në përputhje me standartet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi në Shqipëri.

- Projektuesi duhet të zbatojë dhe t'i referohet kuadrit ligjor që rregullon aktivitetin e tregëtimit në qytetin e Tiranës.
- Gjatë fazave të hartimit të projektit, projektuesi të konsultohet me Agjencinë e Administrimit të Tregjeve (ATA).
- Projektuesi duhet të konsultohet vazhdimisht me Bashkinë përpara fillimit të punës për projektin, ashtu si edhe gjatë të gjitha fazave të projektimit dhe zbatimit të tij dhe kjo si për garantimin e saktësisë së bazës së të dhënave ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme nga plan/studimet e përmendura më sipër.

Përveç saktësisë së të dhënave si më sipër, projektuesi, përpara se të fillojë punën me projektimin duhet që paraprakisht:

1. Të bëjë relievin (azhornimin) e sipërfaqes së zonës; të jepet plani i piketimit (me pikat e forta etj);
2. Të marrë të gjitha azhornimet e rrjetit të infrastrukturës, etj, sipas Formularit 3/1;
3. Projektuesi duhet të bëjë verifikimi paraprak në terren dhe sondime për saktësinë e të dhënave/azhornimeve, për rrjetin e infrastrukturës, përpara fillimit të projektimit. Kjo

duhet në mënyrë që të evitohen pasaktësitë gjatë projektimit dhe zbatimit, si rezultat i të dhënave të marra që nuk përputhen me gjëndjen në terren;

4. Të bëjë studimet përkatëse, hidrologjike etj (sipas kërkesave të projektimit dhe Formularit 3/1).

Konstruksioni

Projektuesi duhet ti kushtojë vëmendje të veçante Strukturave të Metalike që do të parashikohen për realizimin e tregut. Strukturat metalike duhet të parashikohen të tilla që të jenë të aksesueshme nga tregtarët, estetikisht të pershtatshme për funksionin që do të realizojnë. Strukturat preferohen të realizohen me Montim me Buloneri sispas specifikimeve dhe normave në fuqi ose me saldim për ato raste kur realizimi me buloneri veshitëson realizimin e vetë objektit. Mbulesa e Strehave do të parashikohet me panele të lehtësuara sanëich ose panele në formën e materialeve të modifikueshme me qellim kryerjen e funksionit dhe dhenin e formës së pershtatshme arkitektonike projektit.

2.2 Ndriçimi

Ndricuesat do të parashikohen të tipit "led" duke llogaritur lartësinë dhe fuqinë në raport me hapësirat e sheshit.

Linja të jetë me trase nëntokësore ku të vendoset tub plastik fleksibël me dy shtresa me $\varnothing = 90$ mm për kalimin e kabëllit të furnizimit dhe tub metalik me $\varnothing = 100$ mm për intersektim.

Pusetat të jenë prej betoni me përmasa brenda përbrenda 40x40x40 cm me kapak plastike. Distanca ndërmjet pusetave të jetë 25 m larg njëra tjetrës dhe të vendosen mbrapa çdo shtylle për tu mbrojtur nga dëmtimet. Panelet e komandimit të vendosen me komandim sauteri me fotoelementë.

Të parashikohet dalje energjie në puseta të veçanta për zonat e gjelbërta.

Furnizimi me energji i rrjetit të ndriçimit do të bëhet nga kabinat ekzistuese të zonës. Në këto kabina do të instalohen panelet e ndriçimit të cilat do ushqehen me ura të veçanta nga transformatori ekzistues. Në kabinë do parashikohet dhe vendosja e matësve të energjisë. Do të parashikohet tokëzimi i shtyllave të ndriçimit.

Të respektohen normat Europiane të performancës së ndriçimit EN 13201:

Ndriçuesit të jenë me kontroll smart në mënyrë që të rregullohet intensiteti i ndriçimit sipas orëve dhe fluksit të përdorimit të rrugës. Përzgjedhja e normës së ndriçimit sipas PD CEN/TR 13201-1:2014. Të përcaktohet performanca e ndriçimit sipas përdoruesve të rrugës (Makina, Bëçikleta, Këmbësor). Të përcaktohen indikatorët e performancës së energjisë. Treguesi i densitetit të fuqisë metrike (PDI) DP (i matur në $\text{ë}/(\text{lx}\cdot\text{m}^2)$) dhe treguesi vjetor të konsumit të energjisë (AECI) DE (të matur në $\text{ëh}/\text{m}^2$). Të Përcaktohet lloji i rrugës sipas standartit EN 13201 urbane, rurale, parësore, dytësore, në mënyrë që të përcaktohet edhe lloji dhe intensiteti i ndriçimit. Jetëgjatësia e ndriçuesit "Led" sipas standartit IEC 62722-2-1. Të përaktohet temperatura e ndriçimit sipas standartit nga 2500 deri 5000 Kelvin, në mënyrë që të evitohet efekti i

ndotjes (light pollution). Të përcaktohen termat e sigurisë, mbrojtja nga tensioni, nga lagështia etj.

2.3 Ujësjiellësi

Në bashkëpunim me Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. do të saktësohet dhe gjëndja e ujësjiellësit egzistues, si dhe problemet e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë me rrjetin egzistues të ujësjiellësit. Norma e furnizimit do të jetë 150 l/ditë/banor. Materialet që do përdoren për tubacionet e ujësjiellësit do jenë tuba polietileni HDPE-100 për 10 atm që plotësojnë normativat në fuqi, kanë përbërjen kimike dhe aftësinë mbajtëse ndaj presioneve të llogaritura. E njëjta gjë vlen dhe për pajisjet hidraulike dhe aksesorët.

Saraçineskat dhe pajisjet e tjera hidraulike që do të përdoren duhet të jenë $P_n=16$ atm. Për nyjet do të parashikohen puseta me kapak b/a, përmasat e të cilave duhet të realizohen sipas kushteve teknike dhe të sigurojnë kushte normale manovrimi dhe riparimi. Pusetat duhet të jenë te pajisura me shkallë metalike në rastet kur janë të thella.

2.4 Kanalizimet e ujrave të zeza

Qyteti i Tiranës kohët e fundit ka pësuar ndryshime të dukshme në drejtim të shtrirjes së ndërtimeve duke ndjekur dy drejtime kryesore të cilat, në funksion të zhvillimit të tyre kanë sjellë probleme në rrjetin e kanalizimeve. Si drejtim i parë është rritja e intensitetit të ndërtimeve në zonat ekzistuese të ndërtimit dhe drejtimi i dytë është zhvillimi i ndërtimeve në zona pothuaj të pa zhvilluara më parë. Të dy rastet sjellin si rezultat rritjen e sasive të ujrave të zeza dhe ujrave të shiut respektivisht për shkak të rritjes së konsumit të ujit në zonë dhe rritjes së rrjedhës së ujrave të shiut.

Ky treg, shtrihet në një zonë me rritje të intensitetit të ndërtimeve dhe ka nevojë për rritjen e kapacitetit të rrjetit të KUZ.

Nëse është e mundur sistemi i largimit të ujrave të bardha dhe të zeza të jetë i ndarë, në të kundërt të ruhet sistemi miks.

Sasite e ujit që derdhen në sistemin e kanalizimeve. Për sasitë e ujrave të zeza që derdhen në sistemin e kanalizimeve do të përdoren të dhënat e rekomanduara në studimin për kanalizimet e qytetit Tiranë nga firma Japoneze si më poshtë:

$$\begin{aligned} Q_{\text{mes ditë}} &= 194 \text{ l/ditë/banorë} \\ Q_{\text{max orë}} &= 437 \text{ l/ditë/banorë} \end{aligned}$$

Për sasitë e ujrave të shiut do të përdoren të dhënat e Institutit Hidrometeorologjik dhe mënyra e llogaritjes do të paraqitet nga projektuesi në mënyrë të argumentuar.

Siguria Llogaritëse, Siguria llogaritëse e ujrave të shiut do të llogaritet 25 % për kolektorët kryesore dhe 40 % për kolektorët sekondarë.

Vlera e llogaritjes së shiut të merret për periudhë përsëritje 1 herë në vit dhe kohëzgjatje prej 15 minutash. Intensiteti për Tiranën është 150-170litra/sek/ha e cila del me llogaritje.

Materiali kryesor ndërtimor, për kanalizimin do të jetë përdorimi i tubave prej politileni të brinjëzuar të llogaritura për të përballuar ngarkesat ose tubacione betoni me gota, pusetat dhe nënobjektet e tjera do të jenë me material betoni të armuar duke eliminuar përdorimin e materialit të tullës në sistemin e kanalizimeve që ka rezultuar me probleme. Megjithatë projektuesi do të argumentojë materialet që do të përdoren për çdo nën objekt. Pusetat duhet të jenë të pajisura me shkallë metalike.

2.5 Elementët dhe hapësira urbane

Hapësira urbane

Përveç skemës së rrjetit rrugor të brendshëm, projektuesi duhet të trajtojë me projekt zbatim, të gjitha hapësirat urbane, trajtimi i tyre të bëhet me elementë të rikualifikimit urban (shtrim, etj), përveç elementëve të gjelbërimit të lartë apo të ulët sipas rastit dhe specifikave të vendndodhjes, ndarjes së zonës në disa nëndarje me funksione të ndryshme.

Do të jenë fletë të veçanta të projektit, trajtimi dhe detajimi teknik (faza/projekt zbatim) për secilin prej këtyre nëndarjeve të hapësirës urbane.

Përveç sa më sipër, projektuesi duhet të identifikojë të gjitha hapësirat e tjera urbane, të lira ose që lirohen nga projekti, të cilat janë të përshtatshme të planifikohen për ndërhyrje të rikualifikimit urban, ku mund të akomodohen funksione të tilla si ambiente clodhëse (me stola etj) për moshën e tretë, sipërfaqe të gjelbërta etj.

Elementët e mobilimit urban

Një vëmendje të veçantë në projekt, projektuesi duhet t'i kushtojë edhe elementëve të mobilimit urban (ose kur është rasti edhe të artit urban) që do të propozojë të përdoren, në hapësirat urbane të përshkruara më lart, të tilla si: stola, kosha të mbeturinave, vendin e vendosjes së kontenierëve dhe të largimit publik të mbeturinave (përcaktimi i tyre të bëhet në bashkëpunim me drejtorinë e pastrimit në Bashki), zgara apo rrethime të pemëve, kangjella kufizuese në trotuare (kur është rasti), zgarat për bicikletat, etj.

Projektuesi duhet të trajtojë këto elementë në fazën e projektit të zbatimit (me të dhëna të plota për furnizim-vendosje), ku të përcaktojë detaje tip, frekuencën e vendosjes, pra skemën e shpërndarjes së tyre në të gjithë territorin e zonës, llojin e materialit, detaje të inkastrimit, ngjyrat, sasinë, zerin në preventivë, etj.

- Projektuesi gjithashtu duhet të sigurojë azhurnimin e rrjeteve inxhinierike të infrastrukturës për objektin nga institucionet kompetente si dhe të sigurojë miratimin e projekteve elektrike në CEZ.
- Dokumentacioni ligjor që shoqëron dosjen e paraqitur për lejë sheshi dhe ndërtimi sipas formularëve përkatës, azhurnimit të rrjeteve inxhinierike të infrastrukturës etj. (përveç konfirmimit të pronësisë së objektit dhe azhurnimit topografik që do të sigurohen nga bashkia), do të përgatiten nga vetë projektuesi.

Infrastruktura rrugore

Për trajtimin e rrjetit rrugor, gjerësisë së rrugës dhe trotuareve, duhet të mbahen parasysh standartet në fuqi (*Rregullorja e urbanistikës, KTP*).

Akset kryesore të duhet te parashikohen, bazuar ne percaktimet e PDV dhe studimit te zones, për të siguruar kalim të mjeteve dhe këmbësorëve nëpërmjet skemës së qarkullimit të përcaktuar.

Rrugët në të gjithë gjatësinë e tyre duhet të lejojnë aksesin e automjeteve sipas përcaktimeve të rregulloreve ne fuqi.

Shtresat rrugore dhe të trotuarëve të trajtohen të tilla, që të sigurojnë garanci, qendrueshmëri dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe të perspektivës.

Gjatë hartimit të projektit të shikohet mundësia e ndërtimit të parkingjeve si dhe vendosja e pikave të VGM në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse të Bashkisë Tiranë sipas parashikimeve të PDV dhe Planit për ndërtimin e tregut.

Materialet, që do të përdoren, të jenë sipas kushteve teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve.

Në përfundim mund të thuhet se projektuesi duhet të konsultohet vazhdimisht me Bashkinë Tiranë përpara fillimit të punës për projektin, ashtu si edhe gjatë të gjitha fazave të projektimit dhe zbatimit të tij dhe kjo si për garantimin e saktësisë së bazës së të dhënave, ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme nga plan/studimet e përmendura më sipër.

Përveç saktësisë së të dhënave si më sipër, projektuesi, përpara se të fillojë punën me projektimin duhet, që paraprakisht:

- Të bëjë relievin (azhornimin) e rrugëve; të jepet plani i piketimit (me pikat e forta etj);
- Të marrë të gjitha azhornimet e rrjetit të infrastrukturës, sipas *formularit 3/1*;
- Projektuesi duhet të bëjë verifikim paraprak në terren dhe sondime për saktësinë e të dhënave/azhornimeve, për rrjetin e infrastrukturës përpara fillimit të projektimit. Kjo duhet në mënyrë, që të evitohen pasaktësitë gjatë projektimit dhe zbatimit, si rezultat i të dhënave të marra, që nuk përputhen me gjendjen në terren;
- Të bëjë studimet përkatëse gjeologjike, hidrologjike etj. (sipas kërkesave të projektimit dhe *formularit 3/1*).
- Të realizojë gjithashtu koordinim me projektin e rehabilitimit dhe krijimit të hapësirave urbane midis godinave të reja duke përcaktuar gjithashtu kuotat +0.00 m të çdo objekti dhe formën e aksesit të objekteve në rrugët përkatëse duke respektuar çdo normë gjeometrike për realizimin sa me të saktë dhe në përputhje të projekteve të godinave dhe rrugëve.

2.6 Skema e qarkullimit/lëvizjes

Projektuesi duhet të hartojë dhe të paraqesë paraprakisht qarkullimin/lëvizjen në treg.Kjo skemë duhet të jetë fletë e veçantë e projektit.

Projekti/skema duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë:

- Aksesibilitetin për të gjitha kategoritë e mjeteve, duke përfshirë rastet dhe mjetet e emergjencës (sidomos ato të zjarrit, shëndetit etj);
- Parashikimin e mënyrës së lidhjes së tregut me akset kryesore kufitarë;
- Aksesibilitetin e këmbësorëve duke i dhënë një përparësi të qartë në rezervimin e hapësirës së lëvizjes si dhe duke parashikuar lidhjen e lëvizshmërisë së tyre në zonë;
- Nëse tregu ka lidhje me akse kryesore lëvizje që kanë rrjete të transportit publik, duhet të analizohet dhe parashikohet mënyra e ndërlidhjes për lehtësinë në lëvizjen e qytetarëve;
- Aksesibiliteti i personave me aftësi të kufizuara;
- Plotësimin e elementëve të sigurisë rrugore duke trajtuar me kujdes të gjithë elementët (kalimet këmbësore, këndet e shikimit, sinjalistika, ndriçimi, etj.).

Të trajtohet në projekt mënyra e lëvizjes si dhe masat e sigurisë së këmbësorëve gjatë punës për realizimin e objektit në të gjitha fazat. Projektuesi duhet të paraqesi në fletë të veçanta të gjitha detajet e nevojshme të masave të sigurisë që do të reflektohen edhe në preventiv. Plani i propozuar i ndërhyrjes për lirin e sheshit të ndërtimit (prishjet) do të diskutohen me Bashkinë dhe mbasi të marrë miratimin e saj, Projektuesi vazhdon me detajimin në projekt-zbatimin të tregut.

2.7 Sinjalistika

Sinjalistika do të përfshijë sinjalistikën vertikale dhe horizontale në hyrjet e tregut. Për sinjalistikën horizontale do të përdoret bojë speciale.

2.8 Peshoret Elektronike

Gjate projektimit projektuesi duhet ti kushtojë vëmendje të vecante realizimit të peshoreve elektronike në funksion të tregut. Peshoret elektronike do të programohen të tilla që të plotësojnë kapacitetin e kërkuar për tregun. Peshoret që duhet të meren në konsideratë duhet të jenë me kapacitetin peshimi për makineri të mëdha transporti si dhe gjithashtu paletash. Projektuesi duhet të jap detajet teknike për realizimin e tyre sipas normativave në fuqi.

3. Fazat e zbatimit

Për efekt të fondit të zbatimit, të realizimit të prishjeve (të mundshme) si dhe të efikasitetit të ndërhyrjes, projektuesi duhet t'i rekomandojë investitorit fazat e realizimit në kohë (ose sipas elementëve të ndryshëm) të projektit të përcaktuar këtu sipas VKM Nr.354.datë 11.05.2016.

Projektuesi mund t'i rekomandojë Investitorit, që projekti të realizohet në disa faza ose lote, si dhe sipas elementëve të ndryshëm të tij (psh. rrjetit rrugor dhe infrastruktura/punime ndërtimi, apo mobilimi urban/furnizim, vendosje). Projektuesi duhet të përmbahet strukturës së përcaktuar në ligj dhe të miratuar dhe aprovuar nga stafi i Bashkisë Tiranë.

Lidhur me këtë fakt, projektuesi do të propozojë fazat e realizimit të projektit, ku të dhënat (si fletët e projektit, preventiva, grafiku i punimeve) për çdo fazë duhet të jenë të konceptuara ose të organizuara, që të lehtësojnë Investitorin në organizimin e zbatimit (buxhetim, prokurim, kontraktim për zbatim) të projektit me faza.

3.1 Standartet

3.1.1 Standarte në projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim, që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim për këto kategori objektsh dhe statusin e rëndësisë që shfaqin. Rekomandimet duhet të përmbajnë elementë të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për PAK (personat me aftësi të kufizuar). Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga projektuesi në fletë të veçanta të projektit.

3.1.2 Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës. Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të parashikohet dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për urbanistikën”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

3.2 Realizimi i projektit

Realizimi i projektit do të mbështet në fazat e VKM Nr. 354, datë 11.05.2016, Neni 42, Neni 43, Neni 44

FAZA I Analiza e detyrës së projektimit

Analiza e detyrës së projektimit/termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit: Gjetja e kushteve për zgjidhjen e detyrës nëpërmjet planifikimit.

Materialet dorëzohen në format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (cad, excel, word etj.)

FAZA II Projekt ide paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit).

Përpunimi pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit, e cila do paraqitet në jo më pak se 2 variant-propozime, ku për secilin variant do dorëzohet:

- a. Vizatimet teknike (planimetri e përgjithshme, prerje tip të rrugës për secilin variant);
- b. Relacion teknik (mbi ndërhyrjet e parashikuara)
- c. Preventiv paraprak;

Varianti me treguesit më social - ekonomik dhe teknik, që do të përzgjidhet nga Këshilli Teknik, do të vazhdojë procedurën e hartimit të projekt-idesë përfundimtare.

(Të paraqiten variantet e propozuar me preventivat paraprake e specififikimet përkatëse duke përfshirë dhe kostot e shpronësimeve, nëse ka, për secilin variant).

Materialet dorëzohen në format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (cad, excel, word etj.)

FAZA III Projekt ide përfundimtare (planifikimi i sistemit dhe i integritit)

Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së planifikimit.

Pas miratimit në Këshill Teknik të variantit socio-ekonomik dhe teknik më të përshtatshëm të miratuar në fazën e projekt idesë paraprake, procedohet me projekt-idenë përfundimtare, e cila duhet të përmbajë:

- a) Raport teknik;
- b) Preventivin e punimeve sipas formatit të miratuar nga Bashkia Tiranë, referuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”;
- c) Analizat teknike të çmimeve, për zërat, që nuk ndodhen në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.
- d) Vizatimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara me detajet përkatëse.
- e) Specifikimet teknike për zërat e punimeve, që do të kryhen;
- f) Grafikon e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;
- g) Rilevimi;
- h) Studimi gjeologjik;

Materialet dorëzohen në format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (cad, excel, word etj.)

Pranë Drejtorive përkatëse të Bashkisë dhe institucioneve në varësi, kryhet aplikimi për vendosjen në dispozicion të informacionit në lidhje me azhornimet inxhinierike, statusin juridik të pronës etj.

FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit: Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Për këtë për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për leje ndërtimi përmes portalit të Regjistrimit të Integruar të Territorit, të bashkëpunohet me Drejtoritë përkatëse të Bashkisë Tiranë.

FAZA V: Projekti zbatimit: Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

Dosja e plotë e projektit të zbatimit duhet të përmbajë:

1. Raporti Teknik
2. Hartimi i relievit topografik të zonës (koordinata lokale, kuota absolute)
3. Pasqyrimi në projekt i azhurnimeve të rrjetit ekzistues të ujësjiellit, rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut dhe të zeza, rrjetit të elektrikut dhe interenet – telefonisë;
4. Raport gjeologjik;
5. Analizë e situatës ekzistuese dhe të prishjeve të ndërtimeve pa leje (nëse ka);
6. Skemën e qarkullimit në rrugë;
7. Projektin e zbatimit të trases së rrugës;
8. Kuotat e pusetave ekzistuese (koka e tubit, diametri i tubit);
9. Profilin gjatësor të rrugës;
10. Profilat tërthorë të rrugës;
11. Profilat tip të seksionit tërthor të rrugës;
12. Detajet e ndryshme të trotuarit, bordurave, etj;
13. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujërave të shiut;
14. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza;
15. Projektin e zbatimit të rrjetit të ujësjiellit përfshirë dhe detajet e pusetave të pajisjeve dhe rakorderive të njeve, etj;
16. Projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, në vendosjen e hidrantëve zjarrfikës mbështetur në normat në fuqi;
17. Projektin e ndriçimit rrugor, skema e furnizimit me energji elektrike dhe detajet përkatëse;
18. Projektin e zbatimit për ndërtimin e rrjetit të linjave rezervë;
19. Projektin arkitektonik të godinave
20. Projektin Struktural të Godinave
21. Projektet elektrike dhe mekanike të godinave
22. Sinjalistikën rrugore horizontale dhe vertikale dhe parkimet;
23. Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;
24. Preventivin e punimeve mbështetur në manualin teknik të çmimeve në fuqi;
25. Grafikonin e punimeve të ndërtimit;
26. Planin organizimin e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve, që do të jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur dhe në grafikonin e punimeve;
27. Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);
28. Liçensë të firmës projektuese, liçensë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakti i regjistrit tregtar.

Materialet e sipërcituara duhen dorëzuar fizikisht dhe në formatet përkatëse: dëg., ëord, excel.

FAZA VI: Hartimi i preventivit përfundimtar

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në VKM NR. 629, datët. 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ofertat përkatëse të çmimeve.

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizimin e zbatimit me faza, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit

do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të përpilohet sipas formatit/modelit standart të rekomanduar nga Bashkia Tiranë. Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit, do të konsiderohet ai, i cili do të ketë kaluar njëherë të gjitha fazat e mësipërme dhe në rast se preventivi i projekt-zbatimit do të ketë vlerë të barabartë apo më të madhe se 100,000,000 lekë më t.v.sh., projekti do t'i nënshtrohet opionencës teknike të Institutit të Ndërtimit, sipas afateve përkatëse. (të miratuara përkatësisht nga Këshilli Teknik i Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike).

4. Hartimi i Preventivit

Në hartimin e preventivit, vec të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizmin e zbatimit me faza, çmimet e referencës do të jepen nga Bashkia (Drejtoria e Planifikimit Urban/Spektori i Projektimit dhe Standartizimit), sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të paraqitet sipas Formatit/Modelit të rekomanduar nga Bashkia.

5. Standartet

5.1. Standarte në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjate zbatimit. Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuara, të verberit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastruktures për këto kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

5.2. Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, Projektuesi të përdorë programet e kërkuesve kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihet parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për urbanistikën”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

6. Realizimi i projektit

Realizimi i projektit do të mbështet në fazat e VKM Nr. 354, datë 11.05.2016

6.1 Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit

6.2 Projekt idea paraprake dhe përfundimtare:

Projekt idea duhet të realizohet në disa variante, ku për secilin variant duhet të paraqitet relacioni teknik mbi ndërhyrjet, projekti i ndërhyrjeve, kostoja e ndërtimit, grafiku i punimeve dhe specifikimet teknike për secilin variant. Varianti me treguesit më social - ekonomik dhe teknik që do përzgjidhet nga Këshilli Teknik, do vazhdojë procedurën e hartimit të projekt idesë përfundimtare dhe pas miratimit të saj me hartimin e projekt zbatimit.

6.3 Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit:

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Për këtë për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për leje ndërtimi përmes portalit të Regjistrit të Integruar të Territorit, të bashkëpunohet me drejtorinë përkatëse të Bashkisë Tiranë.

6.4 Projekt Zbatimi

Të kryhet hartimi i Projekt - Zbatimit i “Ndërtimi i tregut për shitje me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore (Tirana Agrikulturë) – Faza III- të”, i cili duhet të përmbajë:

1. Raportin Teknik
2. Hartimi i relievit topografik të bllokut (kordinata lokale, kuota absolute)
3. Analizë e situatës ekzistuese dhe të prishjeve të ndërtimeve pa leje.
4. Skemën e rrjetit rrugor, analizën dhe skemën e qarkullimit/lëvizjes në treg.
5. Projektin e zbatimit të traseve të rrugëve.
6. Kuotat e pusetave ekzistuese (koka e tubit, diametri i tubit)
7. Profilat tip të seksionit tërthor të tregut
8. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujrave të shiut.
9. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza.
10. Projektin e zbatimit të rrjetit të ujësjellësit përfshirë dhe detajet e pusetave të pajisjeve dhe rakorderive të nyjeve etj.
11. Projektin e sistemit të ndriçimit pedonal dhe rrugor.
12. Sinjalizimin vertikal dhe horizontal.
13. Projektin e gjelbërimit.
14. Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen.
15. Plan organizimim e punimeve.
16. Ngritja e kantierit.
17. Raportin e vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)

Gjithashtu projektuesi duhet të paraqesë

- Liçensë të shoqërisë projektuese + ekstrakt të regjistrimit tregtar
- Liçensa të inxhinierëve projektues, liçensa të ekspertit mjedisor + deklarata noteriale të inxhinierëve projektues

Rekomandime për projektuesin

Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin egzistues lidhur me tregun e ndertuar dhe prespektives

- Projektuesi duhet të projektoje 2 variante të tregut.
- Projektuesi duhet të hartojë përveç projektit përfundimtar dhe një projekt teknik, i cili duhet të analizojë rast pas rasti të gjitha prishjet e mundëshme për të realizuar me faza këtë investim.
- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia e Tiranës, seksioni i Urbanistikës dhe nga Kadastra. Në hartimin e projektit duhet të kihet parasysh edhe standarte të ndryshme që ka nxjerrë Bashkia e Tiranës siç janë p.sh. tipi i kollonave të ndriçimit, llojet e ndriçuesve e të tjera të kësaj natyre.
- Grupi i projektimit duhet të trajtojë dhe hapsirat e brendëshme të tregut, si zonat e gjelbërta, terrenet sportive, këndet e lojrave për fëmijë, etj.
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standartin e kërkuar.

Projektuesi duhet të ketë parasysh dhe të trajtojë:

- Sistemin egzistues të largimit të ujrave
- Sistemin e furnizimit me ujë të zonës (nqs ka)
- Sistemin e ndriçimit rrugor
- Sistemin e monitorimit dhe vezhgimit.
- Sistemet mekanike.
- Gjelbërimin.
- Punimet provizore.

Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Tiranës. Stafi që kërkohet duhet të mbulojë :

- Inxhinier hidroteknik
- Inxhinier ndërtimi
- Inxhinier gjeolog
- Inxhinier topograf
- Inxhinier elektrik
- Arkitekt
- Inxhinier Mekanik
- Staf mbështetës për fushat e mësipërme.

Raportimi

I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 5 (pesë) kopje origjinale, në version të dixhitalizuar (të dhënat transferohen në GIS) dhe në 5 (pesë) CD.

Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventivi.

Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- Raportin teknik të projektimit arkitektonik
- Raportin teknik të projektimit konstruktiv hidraulik, elektrik, kush/kuz etj
- Llogaritjet statike të strukturave.
- Specifikimet teknike të cilat duhet të jepen për çdo zë pune të parashikuar në preventiv.
- Preventivi i plotë i kushtimit të veprës
- Analizat e cmimeve
- Grafik punimesh
- Vlerësim ndikimi në mjedis (VNM)

Hidrologjia

Të bëhet studimi hidrollojik për të përcaktuar hidromodulin e zonës në studim, analizat dhe llogaritjet e reshjeve në zonë si dhe llogaritjet e shkarkimit maksimal të ujërave.

Planimetria e Shpronësimeve

Kjo planimetri do të identifikojë pronat dhe godinat që preken nga realizimi i projektit dhe gjithashtu të bëhet llogaritja e sipërfaqes që preket për arsye shpronësimi.

Paraqitja e vizatimeve

Vizatimet e projektit duhet të përmbajnë minimum fletët si më poshtë:

1. Topografinë e gjëndjes egzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme (me leje dhe pa leje) ne Shk. 1:500 ose 1:1000
2. Planimetria e sistemimit ne Shk. 1:500 ose 1:1000
3. Profilat gjatesorë Shk. 1:1000, 1:100.
4. Profilat tërthorë
5. Detaje konstruktive
6. Kryqëzimet dhe detaje përkatëse.
7. Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkallën 1: 500
8. Profilat gjatesorë të rrjetit të kanalizimeve në Shk. H1:1000,V1:100
9. Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve
10. Planimetria e rrjetit të ujësjellësit në shkallën 1: 500
11. Profilat gjatesorë të rrjetit të ujesjellësit në Shk. H1:1000,V1:100
12. Pusetat, detajet e nyjeve dhe lidhjeve si dhe detaje të tjera të rrjetit të ujesjellësit.
13. Planimetri dhe detaje për levizshmeri/sinjalistikën rrugore.
14. Planimetria e ndriçimit rrugor dhe detaje të ndriçimit rrugor.
15. Planimetria e gjelberimit të rrugës.
16. Planvendosjen e goddinave te reja
17. Planimetrite dhe plan organizimet
18. Planet e strukturave, prerje detaje strukturore
19. Plane te themeleve

20.Plane sistemimi,

21.Detaje të menyrës së vendosjes së PVC të rrjetit të internet telefonisë dhe intersektimit me rrugët SH 1:25

Gjate dorezimit per te gjithë vizatimet te cilat nuk jane permendur me siper para dorezimit final duhet te mere aprovimi nga specilaisti perkates I Drejtorise se Planifikimit te Puneve Publike me qellim

7. Investimi Themelor

Investimi themelor do të dal nga varianti më i mire i aprovuar nga Këshilli Teknik i Bashkisë së Tiranës.

8. Sqarime të fundit

Të dhënat e nevojshme për projektim, siç janë: gjendja e rrjetit ekzistues të ujësjellësit, të kanalizimeve, ndriçimit, kabinat e tensionit të lartë, vendosja e kontenierëve, planin rregullues të zonës, etj, do t'i bashkangjiten kësaj detyre.